

STATUT

I Shoqërise "BIT POLAR" sh.p.k.

Me cilesine e "ortakut themelues":

Nadezhda KLOFA, atesia Vasili, e dtl.25.10.1975, lindur ne USSR dhe banuese ne Moske, Rusi, ne adresen: Moscow, st. Malaya Cherkizovskaya 66, apt. 141, shtetase ruse, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes me numer 756640818,

Me vullnet të lire të plote e të singerte, mbeshtetur:

Ne Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,

Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare ",

Ne ligjin " Per Qendren Kombëtare të Regjistrimit ", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, ka themeluar një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "**BIT POLAR** " sh.p.k. (me poshtë e quajtur " Shoqëria ")

KREUI

Neni 1

Krijimi

Shoqëria "**BIT POLAR**" sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria "**BIT POLAR**" sh.p.k., është një shoqëri tregtare, e themeluar nga **Ortaku i Vetëm zj.Nadezhda KLOFA**, i cili mbulon humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka selinë në Kavajë, Shqipëri, me adresë: Lagjia Nr.2, Rr."Jurgen Trade", Nr.22, Kavajë, Shqipëri.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e tij, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë



- Krijimin, zhvillimin, prodhimin dhe tregtine edhe ne emer te paleve te treta per software dhe hardware.
- Sherbime IS/IT (Information systems/teknologji) teknologjike, mediatike, dixhitale dhe te inovacionit. Ndertim, zhvillim dhe operim i qendrave te te dhenave.
- Sherbime transmetimi te dhenash, informacione, perpunimi i te dhenave, informacioneve.
- Promocion, reklame, web, websites, webdesigns, sherbime regjistrimi domain, sherbime hosting, promocion digital dhe sherbime te ndryshme te lidhur me internetin.
- Drejtimi me paisje dhe sisteme kompjuterike. Veprimtari te ndryshme te lidhura me teknologji informative dhe sherbime kompjuterike.
- Punet hulumtuese dhe zhvilluese ne lidhje me teknologjine informative dhe veprimtarite e lidhura me to. Edukimi dhe aftesimi ne lidhje me teknologjine informative.
- Studimi, zhvillimi dhe realizimi i faqeve te internetit, faqe te aksesueshme web design si dhe regjistrime, mirembajtje dhe shitje domain internet - housing (administrim, depozitim dhe lidhje) si dhe cdo gje tjeter qe eshte e nevojshme per asistence ne fushen e informatikes.
- Realizim dhe zbulim publiciteti ne web, ne te gjithe menytrat dhe kanalet, si mail, ekran, web radio, web tv, rrjetet sociale dhe te ngjashme.
- Ndertim, administrim, optimizim dhe administrim bazash te te dhenave te profilizuara, si dhe arkivave me informacione dhe artikuj per cdolloj suporti ne respektim te normativave qe permban fusha e privatesise.
- Realizim dhe administrim i njoftimeve "landing page" dhe komunikime shtypi, - e-commerce, - realizim trajnimesh ne fushen informatike.
- Realizim grafike ne web, - projektim, realizim dhe administrim konkursesh online ne respektim me normativat e fushes (lendes).
- Realizim publikimesh, broshurash, revistash mbi produktet dhe sherbimet e siperpermendura, perfshire te drejten per te operuar edhe ne fushen e botimit elektronik dhe telematik.
- Asistence per bizneset, individet, organet publike dhe shoqerite ne pergjithesi, per te ndertuar faqet e internetit dhe sistemeve, menaxhimin e programeve, aparateve dhe sherbimeve per telekomunikacionin dhe telematiken, perfshire sherbimet e transmetimit te te dhenave, imazheve dhe tingujve (me figure dhe ze) me reference te vecante per sherbimet e internetit.
- Ideim, zhvillim, prodhim dhe keshillim ne realizimin e sistemeve baze si dhe cdo gje tjeter qe ka te beje me ruajtjen, trajnimin dhe menaxhimin e te dhenave.
- Ofrimi i sherbimeve te keshillimit te biznesit ne menaxhim dhe informatike, trajnimit, keshillimit dhe organizimit te ceshtjeve te menaxhimit, kerkime dhe zhvillime te marketingut dhe metodave te futjes ne treg.
- Aktivitet teknologjik ne fushen e tekstileve.
- Aktiviteti ne industrine e lehte petrokimike.
- Agjensi imobiliare, blerje, dhënie me qira, ndërmjetësim për pasuri të paluajtshme dhe kryerja e të gjitha shërbimeve në lidhje me pasuritë e



paluajtshme, asistencë për regjistrimin e pasurive të paluajtshme pranë ZVRPP, konsulencë ligjore për shitblerje, marketing.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij për një periudhë kohore të përcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000,00 lekë.

Kapitali i mesipër është nënshkruar dhe shlyer tërësisht në të holla nga "ortaku i vetëm" i shoqërisë:

Nadezhda KLOFA, zotuese e 1 kuote, me vlerë të përgjithshme 100.000,00 Leke, që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë perkundëjt të treteve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë;

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetëm në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortakut të Vetëm të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mbledhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit



*Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organi Vendimmarres

Ortaku i Vetem është organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i Vetem është organi vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i tretë ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

*Administrimi

Administrator i shoqërisë është zj. Nadezhda KLOFA, atesia Vasili, e dtl.25.10.1975, lindur në USSR dhe banuese në Moskë, Rusi, në adresën: Moscow, st. Malaya Cherkizovskaya 66, apt. 141, shtetase ruse, madhore me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes me numer 756640818, e emëruar në këto detyra për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tij, njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) Të përfaqësojë Shoqërinë përpara të gjitha Institucioneve Publike dhe çdo pale të tretë në Shqipëri ose jashtë saj.

ç) Të nënshkruajë dhe të paraqesë të gjitha dokumentet në lidhje me Shoqërinë, hapjen dhe/ose mbylljen e llogarive bankare në emër të Shoqërisë në çdo valutë, si dhe të nënshkruajë dhe të paraqesë të gjitha dokumentet e venojshme në lidhje me llogaritë bankare të Shoqërisë dhe për të marrë të gjitha veprimet ligjore që lidhen me to.

d) Të punësojë dhe të shkarkojë stafin.

e) Të caktojë persona të tretë si avokatë, kontabilistë dhe auditorë tatimorë për të kryer operacione për funksionimin normal të Shoqërisë.

f) Të hartojë dhe të nënshkruajë kontrata me palë të treta në kuadër të aktivitetit të Shoqërisë.

g) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

gj) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

h) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

i) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

j) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuarshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara, Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.
- Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.
- Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Përgjegjësi

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetëm që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13.

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tregëteve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, ortakut të vetem të shoqërisë.

Neni 17

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetem;



c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper " .

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku i Vetem.

Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.



Neni 20

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 22

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakut të Vetem, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë:

a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24
Baza Ligjore

Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Por sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


Neni 25
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26
Dispozita përfundimtare

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe, i lexohet ortakut themelues nga përkthyesja zj. Evelina BACH JENSEN dhe pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortaku themelues i Shoqërisë tregtare "BIT POLAR" sh.p.k., nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale, autenticiteti i të ciles vërtetohet nga Noteri.

ORTAKU I VETEM

 **Nadezhda KLOFA**

Nadezhda Klofa

Përktheu: Evelina BACH JENSEN



REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTERISE

TIRANE

Nr. 2945 Rep.

Nr. 5301 Kol.


VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane, sot me date 23 Tetor 2019 (dymije e nentembedhjete), perpara meje Noteres Publike, Blerina J. AVRAZI, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me adrese Rr."Durrësit", pall.204, u paraqit personalisht shtetasja me identitetin e meposhtem:

- Nadezhda KLOFA, atesia Vasili, e dtl.25.10.1975, lindur ne USSR dhe banuese ne Moske, Rusi, ne adresen: Moscow, st. Malaya Cherkizovskaya 66, apt. 141, shtetase ruse, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet pasaportes me numer 756640818, "*ortak i vetem* " i shoqerise " *BIT POLAR* " sh.p.k..

E cila deklaroi se me vullnetin e saj te lire, te plote dhe te sinqerte, ka redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, statutin e mesiperm dhe pasi iu lexua nga perkthyesja zj.Evelina BACH JENSEN, perthyes ligjore, e njohur nga Ministria e Drejtesise, me numer personal I25318123C nenshkroi pa verejtje duke shkruar emrin, mbiemrin dhe firmen origjinale te saj ne kete zyre, para meje Noteres.

Une Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj te ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimit, me cilesine qe me njeh neni 128 i Ligjit nr.110, date 20.12.2018. " Per Noterine " ne Republiken e Shqiperise.



NOTERE
Blerina J. AVRAZI

Blerina Avrazi